

VENDIM
Nr. 144, datë 22.11.2013

**MBI PEZULLIMIN E PROCEDIMIT TË TRANSFERIMIT TË LICENCËS SË PRODHIMIT DHE
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA “WONDER POWER” SHA TE
SHOQËRIA “BHP ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit nr. 62, regjistri i Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative, ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga ana e Drejtorisë Juridike,

VENDOSI:

1. Pezullimin e procedimit të shqyrtimit të transferimit të licencës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike nga shoqëria “Wonder Power” sh.a. te shoqëria “BHP Energy” sh.p.k.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë “Wonder” sh.a., “Wonder Power” sh.a. dhe “BHP Energy” sh.p.k., si dhe shoqërinë përmbartimore EPSA për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti